



BULETINI ELEKTRONIK I SHOQATËS UJËSJELLËS KANALIZIME TË SHQIPËRISË



**SHUKALB**  
SHOQATA UJËSJELLËS KANALIZIME E SHQIPËRISË

## Qershor 2016

### Reforma në Sektorin e Ujit

#### Workshop i Ministrisë Trajton Marrëveshjet e Performancës dhe Skemat e Subvencionimit të Shoqërive UK



Në kuadër të Reformave të Sektorit të Ujit të miratuara së fundmi nga Këshilli i Ministrave, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, me asistencën e GIZ-it, ka hartuar dy

tipe të marrëveshjeve të performancës, si dhe një skemë të re për subvencionimin e shërbimit të shpërndarjes në sektorin e ujit, bazuar në performancën e shoqërive ujësjellës kanalizime. [lexo më shumë](#)

#### Philip Giantris Intervistohet nga Aqua Strategy mbi Reformën e Ujit në Shqipëri



SHUKALB dëshiron me kënaqësi të ndajë një artikull të veçantë botuar nga revista Aqua Strategy bazuar në një intervistë me Drejtorin Ekzekutiv të SHUKALB, Philip Giantris. Artikulli fokusohet në reformat në sektorin e ujit në Shqipëri, si dhe në përpjekjet e SHUKALB në krijimin e një programi certifikimi bazuar në testim për menaxherët operacionalë të

shoqërive ujësjellës kanalizime në Shqipëri. [lexo më shumë](#)



### Rreth SHUKALB

Shoqata Ujësjiellës Kanalizime e Shqipërisë (SHUKALB), e themeluar në vitin 2000, është një Shoqatë profesionale, jofitimprurëse e profesionistëve në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, e cila synon të përmirësojë menaxhimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri, për ta bërë atë më eficient, të qëndrueshëm dhe efektiv në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Shqipëri.

### Konferenca dhe Ekspozita e Përbashkët Ballkanike!

2-3-4 Nëntor 2016,  
Tiranë, Shqipëri

## Çfarë ka të Re në SHUKALB!

### SHUKALB Vazhdon Dhënien e Kurseve të Trajnimit



Gjatë muajit maj, SHUKALB përfundoi me sukses dhënien e dy kurseve shtesë, të zhvilluar me mbështetjen e USAID nën projektin “Zhvillimi i Qëndrueshëm i

Kapaciteteve në Sektorin e Ujit”. Kursi i parë i trajnimit, “Menaxhimi i Humbjeve të Ujit II” u zhvillua me datë 03 maj 2016, në Tiranë. Kursi u dha nga Inxhinieri Ervin Bucpapaj dhe morën pjesë 12 pjesëmarrës, të përbërë nga kryeinxhinierë, drejtorë ekzekutiv dhe inxhinierë të cilët përfaqësonin shoqëritë e ujësjellësit të Fierit, Gramshit, Shkodrës, Pejës (Kosovë), Divjakës, dhe Bashkisë Shijak. [lexo më shumë](#)

### SHUKALB Firmos Deklaratën e Qëllimit, si Pjesë e Programit të Partneritetit të Studimit të IAWD



Në kuadër të Konferencës së 4-t të Ujit të Danubit, që u mbajt në Vjenë më 11-13 maj, SHUKALB, së bashku me anëtarët e tjerë të Tryezës së Rrumbullakët të Shoqatave të Ujit në

Zonën e Mbullimit të Lumit Danub, nënshkruan Deklaratën e Qëllimit me Shoqatën Ndërkombëtare të Kompanive të Furnizimit me Ujë të Basenit të Lumit të Danub, për krijimin e Partneritetit të Studimit të Danubit (D-LeaP). Siç u tha nga IAWD, D-LeaP parashikon një rajon të Danubit ku të gjithë qytetarët gëzojnë shërbime të qëndrueshme të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. [lexo më shumë](#)

---

## RUAJ DATËN! - Konferenca dhe Ekspozita e Përbashkët Ballkanike, 2-3-4 Nëntor 2016, Tiranë, Shqipëri

---

### Lajme nga Anëtarët Tanë

#### Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Fier Implementon Sistemin GIS

## Bashkohuni me Ne!



Na tregoni se çfarë mendoni!



# UJI DHE PUNËSIMI

KONFERENCA DHE EKSPOZITA E PËRBASHKËT BALLKANIKE

## RUAJ DATËN!

2-4 Nëntor 2016, Tiranë, Shqipëri



**SHUKALB**  
SHOQATA UJËSJELLËS KANALIZIME E SHQIPËRIE



**SHUKOS**  
SHOQATA UJËSJELLËS KANALIZIME E SHQIPËRIE

Konferenca dhe Ekspozita:  
Programi i Konferencës:  
Tel/faks SHUKALB:  
Tel/faks SHUKOS:

info@BalkansJointConference.org  
program@BalkansJointConference.org  
+355 42 245 101, Mob: +355 69 6012782  
+381 38 526 873, Mob: +377 44 182 497, +377 44 926 646



Vitet e fundit ka pasur një rritje të ndërgjegjësimit nga ana e shoqërive Ujësjetës Kanalizime (UK) në

nevojën për të investuar në sistemet GIS, që ofrojnë një identifikim gjeografik dhe inventarizimin e asetëve të infrastructures së shoqërive. Ujësjetës Kanalizime Fier është një nga anëtarët e SHUKALB që ka implementuar së fundmi një system të tillë GIS. [lexo më shumë](#)

### Raporti i Anëtarësimit në SHUKALB deri në Maj 2016

SHUKALB me kënaqësi pranon shoqëritë ujësjetës kanalizime dhe kompanitë private, të cilët u janë bashkuar zyrtarisht SHUKALB, si anëtar në familjen tonë të profesionistëve për këtë vit 2016. Anëtarët e listuar më poshtë kanë përmbushur angazhimin e tyre financiar për SHUKALB duke paguar tarifën e tyre të plotë të anëtarësimit. [lexo më shumë](#)

## Të tjera

### Zyrtarë Shqiptarë Marrin Pjesë si Folës në Programin e Konferencës së Ujit të Danubit



Konferenca e Ujit të Danubit u mbajt në datat 11-13 maj 2016, në Vjenë, Austri, e organizuar bashkërisht nga Banka Botërore dhe Shoqata Ndërkombëtare e Kompanive të

Furnizimit me Ujë të Basenit të Lumit të Danubit (IAWD). Tema e konferencës për këtë vit ishte “Adresimi i sfidave të dyfishta” dhe fliste rreth sfidave në përmbushjen e kërkesave të BE-së, dhe njëkohësisht adresimin e sfidës botërore në përmirësimin e qasjes në shërbimet e ujit dhe kanalizimeve. [lexo më shumë](#)

### Profesionistët e Rinj të Ujit Mbështesin me Pjesëmarrje në Konferencën e Ujit të Danubit



Programi i Ujit të Danubit vazhdon të tregojë angazhmin e saj për Profesionistët e Rinj të Ujit (PRU) në Rajonin e Danubit duke mbështetur pjesëmarrjen e tyre në Konferencën

e Ujit të Danubit, të mbajtur në Vjenë, Austri, më 11-13 maj. Të emëruar nga Shoqatat e tyre Kombëtare, PRU-të nga Austria, Rumania, Hungaria, Kosova, Serbia dhe Shqipëria u përkrahen nga Programi i Ujit të Danubit për të marrë pjesë në Konferencë. [lexo më shumë](#)

### Profesionistë të Rinj të Ujit nga Shqipëria, të Parët e Klasës në Reduktimin e Ujit Pa të Ardhura



SHUKALB është krenar të shpallë suksesin e arritur nga tre profesionistë të rinj të ujit nga Shqipëria të cilët përfunduan testimin e “Trajnimit të Trajnerëve”

për ” Reduktimin e Ujit Pa të Ardhura në Evropën Juglindore”. Inxhinierët ishin Arbana Kola, Specialiste e Zhvillimit të Kurseve nga Projekti i Zhvillimit të Kurseve të SHUKALB, Esida Lekbello, Eksperte e Ujësjetës Kanalizimeve nga Valu Add Management Services; dhe Ervin Bucpapaj, ekspert lokal në zhvillimin e kurseve të trajnimit në Projektin e Zhvillimit të

Kurseve dhe trajner në kursin e SHUKALB “Reduktimi i humbjeve të ujit”.[lexo më shumë](#)

## **Grupimi i PRU-së nga Shqipëria Përfshihet Aktivisht në Konferencën e IWA të PRU-ve të Evropës Lindore**



Konferenca e 8-të e IWA të PRU-ve të Evropës Lindore u zhvillua në Gdansk, Poloni, në 12-14 maj 2016. Kjo konferencë trajtonte një çështje të veçantë, tema e të cilës ishte: ”

Largimi nga Kulla e Fildishtë – Ngushtimi i Hendekut midis Akademisë, Industrisë, Shërbimeve dhe Sektorit Publik “. Meqenëse Gdansk ka reputacionin e qytetit me një histori të gjatë akademike si dhe modern, me një sukses në rritje, përfaqësonte një vend të përsosur për zhvillimin e këtij event.[lexo më shumë](#)

---

[Anëtarësohuni në SHUKALB](#)

[Kurset e Trajnimit](#)

[Na kontaktoni](#)

### **Shoqata Ujës-jellës Kanalizime e Shqipërisë,**

Rruga "Pjeter Bogdani", 39/1, k5, 3, Njësia Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1019, Tirane, Shqiperi

Tel/Fax: (+355/4) 2245 101, Mob: (+355) 69 60 12 782

E-mail: [info@shukalb.al](mailto:info@shukalb.al), Web: [www.shukalb.al](http://www.shukalb.al)